Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0258
Data e Vendimit: 29.04.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "PASTRIMI PRO" SH.P.K.kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave publike në territorin e komunës së Parteshit" me numër prokurimi 658-25-480-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "KOMUNA PARTESH", U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 29.04.2025, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si jashteafatshme, ankesa e OE "PASTRIMI PRO" SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0258, e datës 10.04.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave publike në territorin e komunës së Parteshit" me numër prokurimi 658-25-480-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - "KOMUNA PARTESH", në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- "KOMUNA PARTESH"që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 10/04/2024, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 2025/0258 nga OE "PASTRIMI PRO" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave publike në territorin e komunës së Parteshit", me numër të prokurimit 658-25-480-2-1-1, inicuar "KOMUNA PARTESH" në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 31.01.2025"KOMUNA PARTESH" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë, ku sipas këtij njoftimi Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qen data:

14.03.2025. ndërkaq me datën 07.04.2025 është publikuar njoftimi korrigjim e gabimeve ku afati i fundit ka qen data 10.04.2025.

OE "PASTRIMI PRO" SH.P.K. me 10.04.2025 OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 10.04.20254 AK e ka hedhur poshtë si te jashtafatshme kërkesën për rishqyrtim te Operatorit Ekonomik.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 07.04.2025 është publikuar njoftimi korrigjim e gabimeve ne njoftimet e publikuara, hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 10.04.2025 ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 10.04.2025, e cila me vendimin e AK-së me datën 10.04.2025 e ka hedhur poshtë si te jashtafatshme kërkesën për rishqyrtim me arsyetim është jashtafatshme nga se afati I fundit për dorëzim të ofertave për aktivitetin e prokurimit është data 10.04.2025. Marr parasysh faktin se i njejti aktivitet ka qenë në procedurë ankimore në OSHP,dhe me vendimin e OSHP datë 07.04.2025, i është lejuar vazhdimi i aktivitetit për AK Komuna Partesh.

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 12.03.2025 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik.

-Përfundim-

Neni 108/A paragrafi 3.3 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: "..3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave".

Autoriteti kontraktues - "KOMUNA PARTESH", mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave publike në territorin e komunës së Parteshit" me numër prokurimi 658-25-480-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtijvendimi.

Agim Sheqiri
U.D Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA PARTESH**
- OE - **PASTRIMI PRO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: